



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Në mbështetje të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare Nr.13/29 qershor 2023), si dhe në përputhje me nenin 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (Gazeta Zyrtare Nr.1/05 Janar 2023) duke u bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për kompenzimin për funksionin shtesë, Agjencia e Kosovës për Akreditim shpall:

## **KONKURS**

### **Për anëtar të Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim**

#### **1.Një (1) anëtar jurist me profesion.**

**2.Kohëzgjatja e angazhimit:** Anëtari/ja zgjidhet për një mandat katërvjeçarë me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër

#### **Kualifikimi dhe përshtatshmëria profesionale**

Një kandidat për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 23 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2 dhe 2.3 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim

#### **Kandidati nuk kualifikohet si anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës, nëse:**

- a. Aktualisht është zyrtar ose menaxher në një institucion të arsimit të lart publikë apo privat në Kosovë.
- b. Aktualisht është nëpunës i shërbimit civil;
- c. Aktualisht është i angazhuar në ndonjë subjekt politik në Kosovë, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- d. Ka çfarëdo konflikti të interesit që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat si anëtar i Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim

#### **Kompenzimi**

Kompenzimi i anëtareve të Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Kosovës për Akreditim bëhet në bazë të nenin 38 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (Gazeta Zyrtare Nr.1/05 Janar 2023) si dhe në Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për kompenzimin për funksionin shtesë.

## Procedura e konkurimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në;
- Dokumentin Identifikimi (kopje të dokumentit identifikues, pasaportës, letërnjoftimit apo certifikatës së shtetësisë, e cila duhet të jetë valide).
- Certifikatën mbi gjendjen penale të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrur online në platformën *e-Kosova* do të pranohen);
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (Dëshmitë - Diplomën e kualifikimit profesional të Fakultetit Juridik.
- Vërtetimin e përvojës së punës të lëshuar nga institucioni kompetent përgjegjës - zyra e personelit ku specifikohet data e fillimit dhe data e mbarimit të marrëdhënies së punës.
- Pasqyrat e kontributeve pensionale-Trusti Pensional, ky kriter nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Dëshmitë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI ose të këtë dëshmi që është në proces të nostrifikimit);

## Vlerësimi i CV-së së kandidatëve aplikues

Kandidatët aplikues do të vlerësohen nga një Komision i themeluar sipas paragrafit 4 dhe 5 të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare Nr.13/29 qershor 2023)

## Mënyra e aplikimit

Aplikimi bëhet duke i dërguar dokumentet në E-Mail: [besim.jonuzaj@rks-gov.net](mailto:besim.jonuzaj@rks-gov.net), me përshkrimin në Subjekt: Aplikim për anëtar të Komisionit të Ankesave.

Të gjithë kandidatët e interesuar mund të aplikojnë **nga data 22 mars deri me 05 prill 2024**,

Agjencia e Kosoves për Akreditim inkurajon të gjithë të interesuarit dhe mirëpret aplikimet e secilit kandidatë për tu bërë pjesë e Komisionit të Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).